

Shtojca 1 e

Parashtrimi të Versionit të Redaktuar Publik të Aktakuzës së Konfirmuar

Publike



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-12
**Prokurorja e Specializuar k. Hashim Thaçit, Bashkim
Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit**

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Parashtruesi: Zyra e Prokurorit të Specializuar

Data: 2 dhjetor 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publike

Aktakuzë e Konfirmuar e Redaktuar Publike

Zyra e Prokurorit të Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtësve të të akuzuarve

Administratores
Fidelma Donlon

Prokurorja e Specializuar, në përputhje me kompetencën që ka sipas neneve 35(2)(i) dhe 38(4) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"), akuzon:

Hashim THAÇIN

Bashkim SMAKAJN

Isni KILAJN

Fadil FAZLIUN

Hajredin KUÇIN

për **vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike** dhe **vepra penale kundër rendit publik** të ndëshkueshme në bazë të kapitujve II, XXXI dhe XXXII të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074 (2019) ("KPK"), dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit, sikurse shtjellohet në vijim:

I. TË AKUZUARIT

1. **Hashim THAÇI**, me pseudonimin "Gjarpri", emri i babait Haxhi, u lind më 24 prill 1968 (numri personal [REDAKTUAR]). Gjatë periudhës që mbulon Aktakuza, **Hashim THAÇI** ishte në paraburgim në kontekst të gjykimit të tij në lidhje me akuzat për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit në çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit dhe të tjerëve ("Çështja Thaçi dhe të tjerët")*. **Hashim THAÇI** ishte më parë udhëheqës i UÇK-së dhe anëtar themelues i Partisë për Progres Demokratik të Kosovës, e cila në vitin 2000 mori emrin Partia Demokratike e Kosovës ("PDK"). Ai ka qenë edhe Kryeministër dhe President i Kosovës.

2. **Bashkim SMAKAJ**, emri i babait Tahir, u lind më 1 korrik 1976 (numri personal [REDAKTUAR]). **Bashkim SMAKAJ** ishte më parë drejtor i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë dhe u punësua nga Presidenti i atëhershëm **Hashim THAÇI** nga viti 2017 deri në vitin 2020.

3. **Isni KILAJ**, emri i babait Bajram, u lind më 19 dhjetor 1963 (numri personal [REDAKTUAR]). **Isni KILAJ** ishte anëtar themelues i UÇK-së në Malishevë dhe ish-komandant i njësitit "Lumi". Zëvendësi i tij ishte Vllaznim KRYEZIU. **Isni KILAJ** ka qenë edhe kryetar i PDK-së së **THAÇIT** në komunën e Malishevës.

4. **Fadil FAZLIU**, emri i babait Rrahman, u lind më 15 korrik 1960 (numri personal [REDAKTUAR]). **Fadil FAZLIU** është veteran i UÇK-së i cili veproi në Zonën Operative të Llapit, nën komandën e Rrustem MUSTAFËS, komandanti i Zonës Operative të Llapit.

5. **Hajredin KUÇI**, emri i babait Nezir, u lind më 2 janar 1971 (numri personal [REDAKTUAR]). **Hajredin KUÇI** ka punuar më parë në qeverinë e Presidentit të atëhershëm **THAÇI**, si zëvendëskryeministër dhe ministër i Drejtësisë i Kosovës. Gjatë të gjithë kohës që ka lidhje me Aktakuzën, ai ishte anëtar i ekipit të Mbrojtjes së Kadri VESELIT (një i akuzuar tjetër në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*).

II. PARAQITJA E FAKTEVE

A. VEPRAT PENALE TË PARAQITURA NË AKTAKUZË

6. Të gjitha veprat penale të paraqitura në këtë Aktakuzë kanë lidhje me procese zyrtare të Dhomave të Specializuara të Kosovës ("DHSK"), përfshirë hetimet e Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("ZPS").

7. Sikurse shtjellohet më poshtë, së paku midis 12 prillit 2023 dhe 2 nëntorit 2023, **Hashim THAÇI** zbuloi informacion të fshehtë që i ishte bërë i njohur në gjykimin e tij, në shkelje të urdhrave të gjykatës dhe së bashku me **Fadil FAZLIUN**, **Bashkim SMAKAJN**, **Isni KILAJN** dhe **Hajredin KUÇIN** u bashkërenduan për të ndikuar në mënyrë të paligjshme në dëshmitë e dëshmitarëve të ZPS-së në çështjen *Thaçi dhe të tjerët* dhe/ose për të kontaktuar këta dëshmitarë.

8. Veprimet e të akuzuarve të dhëna me hollësi më poshtë ishin pjesë e një praktike më të gjerë sjelljeje që synonte pengimin e çështjes *Thaçi dhe të tjerët*.

(a) Vizita e 2 korrikut 2023 në qendrën e paraburgimit

9. Më 2 korrik 2023, **Fadil FAZLIU** vizitoi **Hashim THAÇIN** në qendrën e paraburgimit të DHSK-së ("qendra e paraburgimit"). Gjatë vizitës, **Hashim THAÇI** dha informacion konfidencial në lidhje me dëshmitarë të ZPS-së në çështjen *Thaçi dhe të tjerët* dhe udhëzime të hollësishme që **Fadil FAZLIU** duhej t'ia përcillte dëshmitarit të ZPS-së [REDAKTUAR] ([REDAKTUAR], ose "dëshmitari 1"), se si duhej të dëshmonte dëshmitari 1. Në kohën kur u bë vizita, [REDAKTUAR] dëshmitari 1 [REDAKTUAR].

10. **Hashim THAÇI** dhe **Fadil FAZLIU** diskutuan edhe për mënyrën e dhënies së udhëzimeve të **THAÇIT** dhe ranë në marrëveshje që djali i **Fadil FAZLIUT**, Fahri Fazliu, të kontaktonte dëshmitarin 1 për caktimin e një takimi. **Fadil FAZLIU** dhe Fahri FAZLIU ishin takuar më parë me dëshmitarin 1 më 2 qershor 2023, pasi kishin shkëmbyer mesazhe në telefon më 26 qershor 2023. Më 3 korrik 2023, Fahri FAZLIU shkëmbeu mesazhe me dëshmitarin 1 për organizimin e një takimi midis Fahri FAZLIUT, **Fadil FAZLIUT** dhe

dëshmitarit 1 më vonë atë ditë, në përputhje me udhëzimet e **Hashim THAÇIT** për **Fadil FAZLIUN**.

11. Në kohën e kryerjes së kësaj vizite në qendrën e paraburgimit dhe të shkëmbimit të mesazheve, dëshmitari 1 nuk ishte konfirmuar publikisht nga DHSK-ja apo ZPS-ja si dëshmitar në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*. Intervistat e dëshmitarit 1 me ZPS-në ishin klasifikuar si konfidenciale dhe DHSK-ja ose ZPS-ja i ishin referuar atij publikisht, ose: (i) në një mënyrë që nuk zbulonte statusin e tij si dëshmitar i ZPS-së; ose (ii) me kodin e tij të dëshmitarit në proces.

12. Dëshmitari 1 filloi dëshminë e tij në çështjen *Thaçi dhe të tjerët* më [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] vizitës midis **Hashim THAÇIT** dhe **Fadil FAZLIUT** në qendrën e paraburgimit.

(b) Vizita e 3 shtatorit 2023 në qendrën e paraburgimit

13. Më 3 shtator 2023, **Hajredin KUÇI** vizitoi **Hashim THAÇIN** në qendrën e paraburgimit. Gjatë vizitës **Hashim THAÇI** i dha **Hajredin KUÇIT** udhëzime të hollësishme për t'ia përcjellë dëshmitarit të ZPS-së, [REDAKTUAR] ([REDAKTUAR] ose 'dëshmitari 5'), [REDAKTUAR] ([REDAKTUAR] ose 'dëshmitari 2') dhe [REDAKTUAR] ([REDAKTUAR] ose 'dëshmitari 6') lidhur me si duhej të dëshmonte çdo dëshmitar.

14. **Hajredin KUÇI** në mënyrë të përsëritur konfirmoi dhe/ose u pajtua me udhëzimet e **Hashim THAÇIT** lidhur me ndikimin ndaj dëshmitarëve dhe dha sugjerime në lidhje me udhëzimet që duhej t'u jepeshin dëshmitarit 5 dhe dëshmitarit 6. **Hajredin KUÇI** gjithashtu konfirmoi se kishte takuar më parë dëshmitarin 5 të paktën një herë për të diskutuar dëshminë e dëshmitarit 5.

15. [REDAKTUAR].

(c) Vizita e 9 shtatorit 2023 në qendrën e paraburgimit

16. Më 9 shtator 2023, **Bashkim SMAKAJ**, Blerim SHALA, Artan BEHRAMI dhe të tjerë vizituan **Hashim THAÇI** në qendrën e paraburgimit. Gjatë vizitës, **Hashim THAÇI** dha informacion konfidencial për dëshmitarë të ZPS-së në çështjen *Thaçi dhe të tjerët* dhe udhëzoi në mënyrë të përsëritur një ose më shumë prej vizitorëve që t'i jepnin udhëzime dëshmitarit 2 se si të dëshmonte në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*. **Hashim THAÇI** e cilësoi dëshminë e dëshmitarit 2 si vendimtare dhe dha udhëzime të hollësishme se çfarë duhej të thoshte dëshmitari 2 gjatë dëshmisë së tij. **Hashim THAÇI** u kërkoi vizitorëve që të vinin ta takonin sërish pas një muaji në qendrën e paraburgimit.

17. **Bashkim SMAKAJ** dhe Artan BEHRAMI u takuan sërish me **Hashim THAÇI** më 7 tetor 2023, ku Hashim THAÇI dha udhëzime të mëtejshme se si duhej të dëshmonte dëshmitari 2.

18. Gjatë kontrollimit të makinës së **Bashkim SMAKAJT** më 30 tetor 2023, ZPS-ja gjeti një dokument ku trajtohej tema e dëshmisë që pritej të jepte dëshmitari 2, me një version të ngjarjeve që përputhej me udhëzimet e dhëna nga **Hashim THAÇI** gjatë vizitave në qendrën e paraburgimit më 9 shtator dhe 7 tetor 2023.

19. Gjatë të gjithë këtyre ngjarjeve, dëshmitari 2 nuk ishte konfirmuar publikisht nga DHSK-ja apo ZPS-ja si dëshmitar në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*. Intervistat e tij me ZPS-në ishin klasifikuar si konfidenciale dhe DHSK-ja ose ZPS-ja i ishin referuar atij publikisht, ose: (i) në një mënyrë që nuk zbulonte statusin e tij si dëshmitar i ZPS-së; ose (ii) me kodin e tij të dëshmitarit në proces.

(d) Vizita e 6 tetorit 2023 në qendrën e paraburgimit

20. Më 6 tetor 2023, **Isni KILAJ** dhe Vllaznim KRYEZIU vizituan **Hashim THAÇIN** në qendrën e paraburgimit. Ky takim ishte planifikuar një muaj më herët, në një thirrje telefonike në qendrën e paraburgimit midis **Hashim THAÇIT** dhe **Isni KILAJT**.

21. Gjatë vizitës, **Hashim THAÇI** u dha **Isni KILAJT** dhe Vllaznim KRYEZIUT informacion konfidencial për dëshmitarë të ZPS-së në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*. **Hashim THAÇI** dha udhëzime që duhej t'i përcilleshin [REDAKTUAR] ([REDAKTUAR] ose 'dëshmitari 4'), dëshmitar i mbrojtur, se si duhej të dëshmonte. Gjatë dhënies së udhëzimeve, **Hashim THAÇI** dha referenca dhe pjesë të deklaratave konfidenciale të mëparshme të dëshmitarit 4. Gjithashtu, **Hashim THAÇI** diskutoi provat konfidenciale të dëshmitarit të ZPS-së [REDAKTUAR] ([REDAKTUAR], ose 'dëshmitari 3').

22. Gjatë një kontrollit të vendbanimit të **Isni KILAJT** më 2 nëntor 2023, ZPS-ja gjeti materiale që përmbanin informacion konfidencial për proceset e DHSK-së dhe të dhëna identifikuese të dëshmitarëve të mbrojtur, përfshirë edhe emrat e dëshmitarëve. Konkretisht ZPS-ja gjeti mes mbeturinave të **KILAJT** faqe të grisura të deklaratave të mëparshme të dëshmitarit 4, ndër të cilat edhe një pjesë së cilës **Hashim THAÇI** iu referua gjatë vizitës së 6 tetorit 2023. ZPS-ja gjeti gjithashtu edhe fletë fletoreje që përmbanin, ndër të tjera, përmbledhje të dëshmive të pritshme të dëshmitarëve aktualë dhe të mëparshëm të ZPS-së, bashkë me kodet e tyre të dëshmitarit. Shënimet e gjetura në vendbanimin e **KILAJT** përmbajnë informacion që përkon me informacionin në përmbledhjet konfidenciale që iu bënë të njohura **THAÇIT** në kuadër të çështjes *Thaçi dhe të tjerët*.

1. Pengim i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare

23. **Hashim THAÇI**, individualisht dhe me anë të veprimit të përbashkët të grupeve në të cilët bëri pjesë, ndër të tjerë me **Fadil FAZLIUN** dhe Fahri FAZLIUN (“grupi i Fazliut”), **Bashkim SMAKAJN**, Blerim SHALËN dhe Artan BEHRAMIN (“grupi i Smakajt”), dhe **Isni KILAJN** dhe Vllaznim KRYEZIUN (“grupi i Kilajt”), dhe në marrëveshje me **Hajredin KUÇIN**, është përfshirë në një praktikë sjelljeje për të penguar persona zyrtarë, si gjykatës, prokurorë, zyrtarë të gjykatës, zyrtarë të prokurorisë apo persona të autorizuar nga gjykata dhe prokuroria, në kryerjen e detyrave zyrtare. **Hashim THAÇI** i ka drejtuar dhe është përfshirë në këto përpjekje përmes vizitave jo të privileguara që pati në qendrën e paraburgimit gjatë kohës që ishte në paraburgim në kontekst të gjykimit të tij aktual për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

24. Secili nga anëtarët e akuzuar të grupit të Fazliut, grupit të Smakajt dhe grupit të Kilajt u bashkërenduan me synim për të ndikuar ndaj dëshmitarëve të ZPS-së gjatë vizitave jo të privileguara, përkatësisht më 2 korrik 2023, 9 shtator 2023 dhe 6 tetor 2023, të përshkruara më lart në paragrafët 9-12 dhe 16-22.

25. Përmes veprimeve të tyre, **Hashim THAÇI**, **Fadil FAZLIU**, **Bashkim SMAKAJ**, **Isni KILAJ** dhe të tjerë tentuan që të komprometonin aftësinë e DHSK-së/ZPS-së për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet në mënyrë efektive, përfshirë aftësinë e DHSK-së/ZPS-së për të marrë dhe mbrojtur prova relevante të dëshmitarëve.

26. **Hashim THAÇI** ishte drejtuesi ose organizatori i grupeve. Ai dha informacionin konfidencial që i ishte bërë i njohur gjatë gjykimit të tij, që mundësoi (tentativën për) pengimin e personave zyrtarë. Ai gjithashtu u dha udhëzime **Fadil FAZLIUT**, **Bashkim SMAKAJT**, **Isni KILAJT** dhe të tjerëve se si të ndikonin në mënyrë të paligjshme te dëshmitarët e ZPS-së.

27. **Hashim THAÇI, Bashkim SMAKAJ, Isni KILAJ dhe Fadil FAZLIU** kishin synimin dhe dijeninë e nevojshme për veprën penale të pjesëmarrjes në një grup personash, të cilët me veprim të përbashkët tentuan të pengonin persona zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare.

2. Shkelje e fshehtësisë së procedurës

28. Midis së paku 12 prillit 2023 dhe 2 nëntorit 2023, **Hashim THAÇI** u përfshi në një praktikë sjelljeje që synonte shkeljen e fshehtësisë së procedurës në gjykimin *Thaçi dhe të tjerët*.

29. Konkretisht, sikurse shtjellohet në paragrafët 9-12 dhe 16-22 (të përfshirë plotësisht këtu përmes referencave):

- i. **Hashim THAÇI** zbuloi identitetet e dëshmitarëve të ZPS-së ndërkohë që identitetet e tyre dhe përmbajtja e dëshmive që pritej të jepnin ishin klasifikuar si konfidenciale nga DHSK-ja/ZPS-ja;
- ii. **Hashim THAÇI** zbuloi më 6 tetor 2023 informacion konfidencial në lidhje me dëshmitarin 4 në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, përfshirë edhe përmes dhënies së deklaratave të dëshmitarit 4.

30. Sipas ligjit, ky informacion nuk duhej të zbulohej ose ishte shpallur i fshehtë me vendim të gjykatës apo të autoritetit kompetent. Zbulimi i tij nuk ishte autorizuar.

31. Sikurse shtjellohet në paragrafët 9-12 dhe 16-22 më lart, **Hashim THAÇI** kishte synimin dhe dijeninë e nevojshme për veprën penale të shkeljes së fshehtësisë së procedurës përmes zbulimit të paautorizuar të informacionit të fshehtë. **Hashim THAÇI** kishte gjithashtu synimin dhe dijeninë e nevojshme për veprën penale të zbulimit të identitetit dhe të dhënave personale të një dëshmitari të mbrojtur.

3. Mosbindje ndaj gjykatës

32. Me sjelljen e tij të përshkruar në paragrafët 9-22 më lart (të përfshirë plotësisht këtu përmes referencave), **Hashim THAÇI**, nuk iu bind urdhrave të gjykatës në vendimin KSC-BC-2020-06/F00854 në çështjen *Thaçi dhe të tjerët* (konfirmuar me vendimin KSC-BC-2020-06/IA024/F00019) dhe përfshirë në KSC-BC-2020-06/F01226/A01), që (i) lejojnë dhënien e informacionit konfidencial palëve të treta vetëm kur është rreptësisht e domosdoshme dhe me kushte të rrepta; (ii) ndalojnë zbulimin për palë të treta të faktit që një dëshmitar i mbrojtur është i përfshirë në veprimtari të DHSK-së/ZPS-së dhe llojin e përfshirjes; dhe (iii) ndalojnë **Hashim THAÇIN dhe Hajredin KUÇIN** të kontaktojnë dëshmitarë të ZPS-së jashtë kornizës së atij vendimi. **Bashkim SMAKAJ, Isni KILAJ dhe Fadil FAZLIU** ndihmuan **Hashim THAÇIN** për kryerjen e këtyre veprave penale dhe **Hajredin KUÇI** ra në marrëveshje me **Hashim THAÇIN** për të kontaktuar dëshmitarë të ZPS-së në një mënyrë të ndaluar nga vendimi dhe ndërmori veprime të konsiderueshme për jetësimin e asaj marrëveshjeje.

33. Gjithashtu, **Hajredin KUÇI** nuk iu bind urdhrit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për ndalimin e kontaktimit të dëshmitarëve të ZPS-së jashtë kushteve të Protokollit për Kontaktet në fuqi që përfshihet në vendimin KSC-BC-2020-06/F00854, kur i dërgoi dëshmitarit 1 një mesazh telefonik me shkrim, më 12 prill 2023 ose rreth kësaj date.

34. **Hashim THAÇI** gjithashtu nuk respektoi masat mbrojtëse të urdhëruara për dëshmitarin 4 në vendimin [REDAKTUAR].

B. FORMAT E PËRGJEGJËSISË PENALE

35. Me veprimet e tyre të përshkruara më lart, **Hashim THAÇI, Bashkim SMAKAJ, Isni KILAJ, Fadil FAZLIU dhe Hajredin KUÇI** janë përgjegjës për

veprat penale të paraqitura në këtë Aktakuzë përmes formave të përgjegjësive penale në vijim. Ata kishin dijeninë dhe synimin e nevojshëm për secilën formë të përgjegjësive penale dhe secilën veprë penale.

1. Kryerje dhe tentativë

36. **Hashim THAÇI, Bashkim SMAKAJ, Isni KILAJ dhe Fadil FAZLIU** kryen veprën penale të tentativës së pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare sipas nenit 401(2) të KPK-së, lexuar së bashku me nenin 17(1) të KPK-së.

37. **Hashim THAÇI** kreu gjithashtu veprën penale të shkeljes së fshehtësisë së procedurës përmes zbulimit të informacionit të fshehtë, sipas nenit 392(1) të KPK-së.

38. **Hashim THAÇI dhe Hajredin KUÇI** gjithashtu kryen veprën penale të mosbindjes ndaj gjykatës përmes shkeljeve të urdhrave të gjykatës, sipas nenit 393 të KPK-së, lexuar së bashku me nenin 17(1) të KPK-së.

39. **Hashim THAÇI** kreu gjithashtu veprën penale të shkeljes së fshehtësisë së procedurës përmes zbulimit të identitetit dhe të dhënave personale të një dëshmitari të mbrojtur, sipas nenit 392(2) të KPK-së, lexuar së bashku me nenin 17(1) të KPK-së.

2. Marrëveshje për kryerjen e veprave penale

40. Përmes një apo më shumë prej veprimeve të përshkruara në paragrafët 9-12 dhe 16-22, anëtarët e grupit të Fazliut, grupit të Smakajt dhe grupit të Kilajt, në bazë të nenit 35 të KPK-së, ranë në marrëveshje për kryerjen e veprës penale të tentativës për pengim të personave zyrtarë dhe një apo më shumë

prej personave që ishin pjesëtarë të atyre marrëveshjeve, ndërmorën veprime të konsiderueshme për kryerjen e veprave penale.

41. Përmes sjelljes së tyre të përshkruar në paragrafët 13-15 më lart, **Hashim THAÇI** dhe **Hajredin KUÇI**, sipas nenit 35 të KPK-së, ranë në marrëveshje për kryerjen e veprimeve të konsiderueshme për kryerjen e veprës penale të mosbindjes ndaj gjykatës.

3. Nxitje

42. Përmes një apo më shumë prej veprimeve të përshkruara në paragrafët 9-12 dhe 16-22, **Hashim THAÇI** nxiti anëtarët e tjerë të grupit të Fazliut, grupit të Smakajt dhe grupit të Kilajt që të kryenin veprën penale të tentativës për pengim të personave zyrtare sipas nenit 35 të KPK-së.

4. Ndhimë

43. Së fundi, përmes një apo më shumë prej veprimeve të përshkruara në paragrafët 9-12 dhe 16-22 më lart, **Bashkim SMAKAJ**, **Isni KILAJ** dhe **Fadil FAZLIU** ndihmuan brenda secilit grup dhe ndërmjet grupeve të tyre përkatëse, si edhe ndihmuan **Hashim THAÇIN**, në kryerjen e veprave penale të tentativës për pengim të personave zyrtare dhe mosbindjes ndaj gjykatës, sipas nenit 33 të KPK-së.

III. PARAQITJA E VEPRAVE PENALE

44. Përmes veprimeve të përshkruara më lart, **Hashim THAÇI, Bashkim SMAKAJ, Isni KILAJ, Fadil FAZLIU** dhe **Hajredin KUÇI** janë përgjegjës për veprat penale të paraqitura në këtë Aktakuzë.

45. **Hashim THAÇI** mban përgjegjësi penale individuale për:

- **Pika 1: TENTATIVË PËR PENGIM TË PERSONAVE ZYRTARË NË KRYERJEN E DETYRAVE ZYRTARË**, me anë të pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi, midis së paku 26 qershorit dhe 18 korrikut 2023, VEPËR PENALE KUNDËR RENDIT PUBLIK, e ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 21, 32(1), 35 dhe 401(2)-(3) dhe (5) të KPK-së dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.
- **Pika 2: TENTATIVË PËR PENGIM TË PERSONAVE ZYRTARË NË KRYERJEN E DETYRAVE ZYRTARË** me anë të pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi, midis së paku 9 shtatorit dhe 30 tetorit 2023, VEPËR PENALE KUNDËR RENDIT PUBLIK, e ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 21, 32(1), 35 dhe 401(2)-(3) dhe (5) të KPK-së dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.
- **Pika 3: TENTATIVË PËR PENGIM TË PERSONAVE ZYRTARË NË KRYERJEN E DETYRAVE ZYRTARË** me anë të pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi, midis së paku 6 tetorit dhe 2 nëntorit 2023, VEPËR PENALE KUNDËR RENDIT PUBLIK, e ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 21, 32(1), 35 dhe 401(2)-(3) dhe (5) të KPK-së dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.
- **PIKA 4: SHKELJE E FSHEHTËSISË SË PROCEDURËS**, përmes zbulimit të paautorizuar të informacionit të fshehtë, midis së paku 26 qershorit dhe 18 korrikut 2023, VEPËR PENALE KUNDËR ADMINISTRIMIT TË DREJTËSISË DHE ADMINISTRATËS PUBLIKE, e ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 21 dhe 392(1) të KPK-së dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.
- **Pika 5: SHKELJE E FSHEHTËSISË SË PROCEDURËS**, përmes zbulimit të paautorizuar të informacionit të fshehtë, midis së paku 9 shtatorit dhe 30 tetorit 2023, VEPËR PENALE KUNDËR ADMINISTRIMIT TË DREJTËSISË DHE ADMINISTRATËS PUBLIKE, e ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 21 dhe 392(1) të KPK-së dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.

- **Pika 6: SHKELJE E FSHEHTËSISË SË PROCEDURËS**, përmes zbulimit të paautorizuar të informacionit të fshehtë, midis së paku 6 tetorit dhe 2 nëntorit 2023, VEPËR PENALE KUNDËR ADMINISTRIMIT TË DREJTËSISË DHE ADMINISTRATËS PUBLIKE, e ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 21 dhe 392(1) të KPK-së dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.
- **Pika 7: SHKELJE E FSHEHTËSISË SË PROCEDURËS**, përmes zbulimit të paautorizuar të identitetit dhe të dhënave personale të një dëshmitari të mbrojtur, midis së paku 6 tetorit dhe 2 nëntorit 2023, VEPËR PENALE KUNDËR ADMINISTRIMIT TË DREJTËSISË DHE ADMINISTRATËS PUBLIKE, e ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 21, dhe 392(2) të KPK-së dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.
- **Pika 8: MOSBINDJE NDAJ GJYKATËS**, midis së paku 26 qershorit dhe 18 korrikut 2023, VEPËR PENALE KUNDËR ADMINISTRIMIT TË DREJTËSISË DHE ADMINISTRATËS PUBLIKE, e ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 21 dhe 393 të KPK-së dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.
- **Pika 9: MOSBINDJE NDAJ GJYKATËS**, midis së paku 1 dhe 13 shtatorit 2023, VEPËR PENALE KUNDËR ADMINISTRIMIT TË DREJTËSISË DHE ADMINISTRATËS PUBLIKE, e ndëshkueshme në bazë të neneve 21, 35 dhe 393 të KPK-së dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.
- **Pika 10: MOSBINDJE NDAJ GJYKATËS**, midis së paku 9 shtatorit dhe 30 tetorit 2023, VEPËR PENALE KUNDËR ADMINISTRIMIT TË DREJTËSISË DHE ADMINISTRATËS PUBLIKE, e ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 21 dhe 393 të KPK-së dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.
- **Pika 11: MOSBINDJE NDAJ GJYKATËS**, midis së paku 6 tetorit dhe 2 nëntorit 2023, VEPËR PENALE KUNDËR ADMINISTRIMIT TË DREJTËSISË DHE ADMINISTRATËS PUBLIKE, e ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 21 dhe 393 të KPK-së dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.

46. **Bashkim SMAKAJ** mban përgjegjësi penale individuale për:

- **Pika 12: TENTATIVË PËR PENGIM TË PERSONAVE ZYRTARË NË KRYERJEN E DETYRAVE ZYRTARE**, me anë të pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi, midis së paku 9 shtatorit dhe 30 tetorit 2023, VEPËR PENALE KUNDËR RENDIT PUBLIK, e

ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 21, 33, 35 dhe 401(2) dhe (5) të KPK-së dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.

- **Pika 13: MOSBINDJE NDAJ GJYKATËS**, midis së paku 9 shtatorit dhe 30 tetorit 2023, VEPËR PENALE KUNDËR ADMINISTRIMIT TË DREJTËSISË DHE ADMINISTRATËS PUBLIKE, e ndëshkueshme në bazë të neneve 21, 33 dhe 393 të KPK-së dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.

47. **Isni KILAJ** mban përgjegjësi penale individuale për:

- **Pika 14: TENTATIVË PËR PENGIM TË PERSONAVE ZYRTARË NË KRYERJEN E DETYRAVE ZYRTARE**, me anë të pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi, midis së paku 6 tetorit dhe 2 nëntorit 2023, VEPËR PENALE KUNDËR RENDIT PUBLIK, e ndëshkueshme sipas neneve 17, 21, 33, 35 dhe 401(2) dhe (5) të KPK-së dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.
- **Pika 15: MOSBINDJE NDAJ GJYKATËS**, midis së paku 6 tetorit dhe 2 nëntorit 2023, VEPËR PENALE KUNDËR ADMINISTRIMIT TË DREJTËSISË DHE ADMINISTRATËS PUBLIKE, e ndëshkueshme në bazë të neneve 21, 33 dhe 393 të KPK-së dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.

48. **Fadil FAZLIU** mban përgjegjësi penale individuale për:

- **Pika 16: TENTATIVË PËR PENGIM TË PERSONAVE ZYRTARË NË KRYERJEN E DETYRAVE ZYRTARE**, me anë të pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi, midis së paku 26 qershorit dhe 18 korrikut 2023, VEPËR PENALE KUNDËR RENDIT PUBLIK, e ndëshkueshme sipas neneve 17, 21, 33, 35 dhe 401(2) dhe (5) të KPK-së dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.
- **Pika 17: MOSBINDJE NDAJ GJYKATËS**, midis së paku 26 qershorit dhe 18 korrikut 2023, VEPËR PENALE KUNDËR ADMINISTRIMIT TË DREJTËSISË DHE ADMINISTRATËS PUBLIKE, e ndëshkueshme në bazë të neneve 21, 33, dhe 393 të KPK-së dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.

49. **Hajredin KUÇI** mban përgjegjësi penale individuale për:

- **Pika 18: MOSBINDJE NDAJ GJYKATËS**, midis së paku 1 dhe 13 shtatorit 2023, VEPËR PENALE KUNDËR RENDIT PUBLIK, e

ndëshkueshme sipas neneve 21, 35 dhe 393 të KPK-së dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.

- **Pika 19: MOSBINDJE NDAJ GJYKATËS**, më 12 prill 2023 ose rreth kësaj date, VEPËR PENALE KUNDËR ADMINISTRIMIT TË DREJTËSISË DHE ADMINISTRATËS PUBLIKE, e ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 21 dhe 393 të KPK-së dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.

50. Të gjitha pjesët e kësaj Aktakuze duhen lexuar në lidhje me njëra-tjetrën.

/nënshkrimi/

Kimberli P. Uest
Prokurore e Specializuar

E hënë, 2 dhjetor 2024

Në Hagë, Holandë.